VENDIM
Nr.4, datë 6.1.1997

PËR DALJEN JASHTË PËRDORIMIT TË PASAPORTAVE DIPLOMATIKE E TË SHËRBIMIT TË TIPIT TË VJETËR

Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pasaportat diplomatike dhe të shërbimit të tipit të vjetër të konsiderohen të pavlefshme, duke filluar nga data 31 janar 1997.

2. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Brendshme të marrin masat përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi